

Të dhëna bazike të lëndës - SYLLABUSI				
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike			
<b>Departamenti</b>	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment Komunikacion dhe Transport			
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Grafika inxhinierike</b>			
<b>Niveli:</b>	Bachelor			
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative			
<b>Semestri</b>	I			
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2			
<b>Vlera në kredi - ECTS:</b>	6.5			
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Asoc. Dr. Shpetim Lajqi			
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p><u>Vizatimi teknik:</u> Hyrje. Llojet e vizatimeve teknike. Njohuri me standardet teknike. Numrat standard. Vijat për vizatim. Përpjesa. Formatet. Tabelat. Konstruktimi i objekteve gjeometrike. Shkrimi teknik. Dimensionimi dhe kuotimi. Rregullat e projektimit në vizatim teknik. Prerjet. Skicimi. Paraqitja e vizatimeve teknike.</p> <p><u>Gjeometria Deskriptive:</u> Projeksioni i elementeve gjeometrike. Prerjet e trupave. Zhvillimi i sipërfaqeve të trupave. Perspektiva. Shenjat e trafikut. Paraqitja aksonometrike e trupave.</p>			
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i lëndës është aftësimi i studentëve nga lëmia e Grafikës Inxhinierike.			
<b>Rezultatet e pitura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të përvetësojnë: Shkronjat teknike, llojet e vijave, llojet e letrës, formatet, tabelat. Vizatimin e konstruksioneve gjeometrike. Skicimin. Rregullat e dimensionimit. Paraqitjen e pikave, vijave, objekteve dhe trupave të ndryshëm në hapësirë. Prerjen dhe ndërhyrjen e trupave gjeometrik. Vizatimin e objekteve dhe trupave në projeksione. Krijimin e vizatimeve teknike dhe makinerike. Paraqitjen dhe leximin e vizatimeve teknike.			
Kontributi në ngarkesën e studentit (Që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)				
Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2		15	30
Ushtrime teorike / laboratorike	2		15	30
Punë praktike	1		2	2
Kontaktet me mësimdhënësin / konsultimet	15 min		8	2
Ushtrime në teren	0		0	0
Kollokfiume, seminare	3		5	15
Detyra të shtëpisë	3		15	45
Koha e studimit vetanak të studentit (bibliotekë ose shtëpi)	2		8	16
Përgatitja përfundimtare për provim	5		2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2		4	8
Projektet, Prezantimet, etj.	1		5	5
<b>Totali</b>				<b>163</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime.			
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik:</b> Detyrat e shtëpisë, Kollokvium, Seminare, Projekte, Vijueshmëri, etj.	<b>Pjesa teorike</b>		<b>Pjesa praktike</b>	
	<b>40%</b>		<b>60%</b>	

<b>Mënyra e dhënies së provimit:</b>	Testimi gjatë vitit, seminaret dhe provimi përfundimtar.
<b>Literatura bazë:</b>	[1] Musli Bajraktari, Ilir Doçi: <i>Grafika inxhinierike</i> , Prishtinë, 2012. [2] K.C. John, <i>Engineering Graphics for Diploma</i> , PHI Learning Private Limited, 2009. [3] Hans Hoischen, <i>Technisches Zeichnen, Grundlagen, Normen, Beispiele Darstellende Geometrie</i> , Cornelsen, 2002.
<b>Literatura shitesë:</b>	[1] K.C. John: <i>Engineering Graphics for Diploma</i> , PHI Learning Private Limited, 2009. [2] Musli Bajraktari, Ilir Doçi: <i>Prezetime nga Grafika Inxhinierike</i> , 2011. [3] Musli Bajraktari, Ilir Doçi: <i>Vizatimi teknik</i> , Prishtinë, 2010. [4] Musli Bajraktari: <i>Gjeometria deskriptive</i> , Prishtinë, 2004. [5] Nijazi Ibrahim, Vizatim teknik, Prishtinë, 1986. [6] Colin H Simmons, Dennis E Maguire, <i>Manual of Engineering Drawing</i> , Elsevier, 2004. [7] Milan Opalic, Milan Kljajin, Slavko Sebastijanovic: <i>Tehničko crtanje, sveučilišni udzbenik, Fakultet Strojarsva i Brodogradnje, Zagreb, 2007.</i> [8] Standardet CEN/EN, <a href="http://www.cen.eu">http://www.cen.eu</a> .
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Grafikën Inxhinierike. Informimi mbi lëndën, testet, detyrat seminarike. Instrumentet grafike dhe përdorimi i tyre. Llojet e vizatimeve. Standardet. Numrat standard.
<i>Java e dytë:</i>	<u>Vizatimi Teknik</u> . Llojet e vijave dhe aplikimi i tyre. Formatet dhe palosja e tyre. Tabelat. Përpjesët në vizatim teknik.
<i>Java e tretë:</i>	Vizatimi i konstruksioneve gjeometrike. Konstruktimi i rasteve të drejtëzave. Konstruktimi i këndeve. Konstruktimi i harkut dhe tangjentes në hark. Konstruktimi i shumëkëndëshave. Vijat e ndërlikuara. Konstruktimi i lakoreve – elipsa, parabolla, hiperbolla, evolventa e rrethit, Cikloida, Spirala, Heliksa.
<i>Java e katërt:</i>	Shkronjat teknike, shkrimi i drejtë dhe i pjerrët, simbolet. Dimensionimi. Rregullat e dimensionimit dhe kuotimit.
<i>Java e pestë:</i>	Materialet në vizatim teknik. Kualiteti i sipërfaqeve dhe shenjat e kualitetit.
<i>Java e gjashtë:</i>	Projeksionet. Llojet e projeksioneve. Projektioni izometrik. Projektioni i pjerrët. Projektioni perspektiv.
<i>Java e shtatë:</i>	Prerjet. Prerjet e trupave me rrafsh. Prerja e plotë, gjysmë prerjet, prerjet e pjesërishme. Prerjet e shkallëzuara.
<i>Java e tetë:</i>	Paraqitja e saktë e vizatimeve. Skicimi. Paraqitja e skicës së vizatimit. Paraqitja (vizualizimi) i detaleve në tri projeksione ortogonale.
<i>Java e nëntë:</i>	Paraqitja e pjesës makinerike në vizatim teknik me të gjitha elementet. Shembuj të zgjidhur. Simbolet në vizatim teknik. <i>Testi I (Java e parë ose e dytë e nëntorit)</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<u>Gjeometri deskriptive</u> . Projektionet e pikave. Projektionet e drejtëzave. Rrafshet e projektimit. Raporti në mes të pikës, drejtëzës dhe rrafshit.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Transformimi dhe rrotullimi. Projektionet e figurave në rrafsh. Problemet metrike.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Formimi dhe prerja e trupave
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Zhvillimi i sipërfaqeve të trupave për Prodhimtari Prespektiva. Shenjat e trafikut për programin Komunikacion
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Paraqitja e trupave në aksonometri
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Testi II (Java e fundit e dhjetorit).</i>

<p><b>Mënyra e dhënies së provimit:</b></p>	<p>Studentët duhet ti kryejnë të gjitha punimet seminarike për tu notuar. Provimi mund të kryhet përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjatë semestrit. Janë gjithsejtë dy teste. Testi i parë është nga Vizatimi Teknik që i ka 50% dhe mbahet në javën parë ose të dytë të nëntorit ndërsa testi i dytë nga Gjeometria Deskriptive me 50% të vlerës së provimit dhe mbahet në fund të muajit dhjetor.</p> <p>Nëse studentet nuk arrijnë ta përfundojnë provimin me teste, atëherë i nënshtrohen provimit nëpër afate që i publikon fakulteti.</p> <p>Notat sipas pikave:</p> <p>0.....49.9 pika – Nota: <b>5 (pesë)</b></p> <p>50...60.9 pika – Nota: <b>6 (gjashtë)</b></p> <p>61...70.9 pika – Nota: <b>7 (shtatë)</b></p> <p>71...80.9 pika – Nota: <b>8 (tetë)</b></p> <p>81...90.9 pika – Nota: <b>9 (nëntë)</b></p> <p>91...100 pika – Nota: <b>10 (dhjetë)</b></p>
<p><b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b></p>	<p><b>Studentët duhet të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe të jetë aktiv gjatë kursit mësimor. Nuk lejohet prishja e qetësisë dhe përdorimi i telefonit gjatë orëve të mësimit.</b></p>